



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 888/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Fisnik Nazifi, kandidat për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga radhët e Iniciativës Qytetare NE MUNDEMI, me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar Apeli Anr.888/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga Fisnik Nazifi, kandidat për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga radhët e Iniciativës Qytetare NE MUNDEMI, me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për Kuvendin Komunal në Ferizaj të Iniciativës Qytetare NE MUNDEMI, në Vendvotimet: 2510D/04R; 2510D/05D; 2534D/02D; 2504D/04R; dhe Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

III. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit paraqitur nga Fisnik Nazifi, kandidat për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga radhët e Iniciativës Qytetare NE MUNDEMI, me seli në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar rinumërimin, për vendvotimet: 2501Y/08R; 2501Y/07R; 2707D/04R

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.856/2021 nga Fisnik Nazifi, kandidat për Kuvendin Komunal në Ferizaj nga radhët e nga radhët e Iniciativës Qytetare NE MUNDEMI,

me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën kërkon që te rinumërohen vendvotimet 2510D/04R; 2510D/05D; 2534D/02D; 2504D/04R; 2501Y/08R; 2501Y/07R; 2707D/04R pasi që dyshon se është bere shkelje ligjore pasi që pretendon se i mungojnë votat e familjareve të tij. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa votuesve për te cilët pretendon se kane votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të votave të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajt Fisnik Nazifi nga Iniciativa Qytetare NE MUNDEMI me provat e ofruara nga pala ankuese, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vet pala ankuese andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga Iniciativa Qytetare NE MUNDEMI me seli në Ferizaj për Vendvotimet: 2510D/04R; 2510D/05D; 2534D/02D; 2504D/04R; dhe rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Apeli në pikën III të dispozitivit është i pa bazuar për arsye se nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal Fisnik Nazifi nga Iniciativa Qytetare NE

MUNDEMI, kërkon rinumërimin e votave për vendvotimet: 2201E/01R; 2201E/02R; 2206E/01R; 2215E/01R, është i pa bazuar për faktin se për të njëjta vendvotime, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtat vendvotime të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesi nuk ka ofruar prova shpresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si të tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme.

Ndërsa për vendvotimin 2707D/04R ka vendosur që ta refuzoj apelin për arsye se ky vendvotim nuk i përket Komunës së Ferizaj gjegjësisht fshatit Greme për të cilin pala ankuese ka pretenduar.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.888/21 më datë 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.